



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 44

2002

Korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 334, datë 11.7.2002	Për përbërjen e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja e për mënyrën dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të tij	1279
Vendim i KM nr. 335, datë 11.7.2002	Për një shtesë në vendimin nr.613, datë 13.12.1993 të Këshillit të Ministrave "Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive", ndryshuar me vendimin nr. 142, datë 4.3.1996 të Këshillit të Ministrave.....	1280
Vendim i KM nr. 342, datë 11.7.2002	Për dhënien me qira, me ankand, të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive dhe institucioneve shtetërore.....	1280
Vendim i KM nr. 343, datë 11.7.2002	Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë	1283

Vendim i KM nr. 346, datë 13.6.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet përkatëse dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet përkatëse"	1285
Vendim i Gj.L nr. 39, datë 30.5.2002	Me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së vendimit nr.1, datë 3.11.1994 të mbledhjes së ortakëve të shoqërisë tregtare "Birra Korça", sh.p.k.....	1286
Vendim i Gj.L nr. 46, datë 6.6.2002	Me objekt anulimin e vendimit nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë; detyrim njohje pronarë.....	1289
	Kërkesë për shpronësim	1294
	Kërkesë për shpronësim	1295

VENDIM
Nr. 334, datë 11.7.2002

**PËR PËRBËRJEN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË AGJENCISË SË NXITJES SË
INVESTIMEVE TË HUAJA E PËR MËNYRËN DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË
ANËTARËVE TË TIJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 9 të ligjit nr.8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja përbëhet nga kryetari dhe 9 anëtarë, si më poshtë vijon:

- | | |
|---|---------|
| - Ministri i Ekonomisë | kryetar |
| - Zëvendësministri i Ekonomisë | anëtar |
| - Zëvendësministri i Financave | anëtar |
| - Zëvendësministri i Industrisë dhe Energjetikës | anëtar |
| - Zëvendësministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit | anëtar |
| - Zëvendësministri i Bujqësisë dhe Ushqimit | anëtar |
| - 4 përfaqësues nga organizatat e biznesit | anëtar. |

2. Kandidatët për anëtarë në Këshillin Mbikëqyrës të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja, përfaqësues të organizatave të biznesit, zgjidhen me sistem rotacioni, sipas përcaktimit të Këshillit Mbikëqyrës të kësaj Agjencie ndërsa kriteret e zgjedhjes së këtyre anëtarëve përcaktohen nga Ministri i Ekonomisë.

3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është i përmuajshëm, por kushtëzohet nga pjesëmarrja në çdo mbledhje.

Masa e shpërblimit të jetë si më poshtë vijon:

- për kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës 30 për qind e pagës mujore të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja;
- për anëtarët 20 për qind e pagës mujore të Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 335, datë 11.7.2002

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.613, DATË 13.12.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NDËRTIM DHE PROJEKTIM
TË SHOQËRIVE", NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR. 142, DATË 4.3.1996 TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7, 12 dhe 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.613, datë 13.12.1993 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimin nr.142, datë 4.3.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhet shtesa si më poshtë vijon:

Në pikat 1 dhe 2, pas fjalëve "...të laboratorëve të kontrollit të materialeve të ndërtimit" shtohen fjalët "të mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 342, datë 11.7.2002

**PËR DHËNIEN ME QIRA, ME ANKAND, TË OBJEKTEVE TË NDËRMARRJEVE,
SHOQËRIVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Procedurat e dhënies me qira:

I.1. Objektet e ndërmarrjeve, të shoqërive dhe të institucioneve shtetërore, ku përfshihen ndërtesat, trualli i lirë funksional (jo nën ndërtesë), linjat teknologjike, makineritë e pajisjet u jepen me qira të tretëve, me ankand.

Në raste të veçanta, kur forma e ankandit nuk mund të përdoret, dhënia me qira të tretëve bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

I.2. Dokumentacioni për dhënien me qira të objektit përgatitet nga ndërmarrja, shoqëria apo institucioni shtetëror që ka objektin në administrim dhe përmban:

a) miratimin e organit drejtues së ndërmarrjes, shoqërisë dhe institucionit shtetëror për dhënien me qira dhe afatin e dhënies me qira;

b) gjenplanin e objektit; ku të jenë shënuar sipërfaqja e truallit nën ndërtesë dhe sipërfaqja e truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë) dhe të vërtetuar nga seksioni i urbanistikës së organit të qeverisjes vendore dhe organi drejtues që ka të drejtën e përfaqësimit të personit juridik për ndërmarrjen, shoqërinë apo institucionin shtetëror;

c) listën e makinerive, pajisjeve, linjave teknologjike, galerive minerare etj., të cilat do të jepen me qira, vlerat kontabël të tyre dhe vitin e blerjes;

ç) aktin e vlerësimit të truallit, të lëshuar nga seksioni i financës së organit të qeverisjes vendore;

d) tabelën e përlllogaritjes së çmimit dysheme të qirasë së objektit.

Dokumentacioni i përgatitur dërgohet në degën e shoqërisë publike, të prefekturës përkatëse, e cila, brenda 15 ditëve, ia përcjell ministrisë ose organit të qeverisjes vendore, që ushtron të drejtën e administruesit të ndërmarrjes, institucionit apo shoqërisë, objekti i të cilit jepet me qira, për të plotësuar dokumentacionin me miratimin e tyre.

I.3. Dokumentacioni për dhënien me qira të objekteve, i përgatitur si më lart, dërgohet, brenda 15 ditëve, në Ministrinë e Ekonomisë që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore, i cili jep miratimin për dhënien me qira dhe përcakton afatin e qiradhënies.

I.4. Ministria e Ekonomisë, që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore, e dërgon dokumentacionin, brenda 15 ditëve, në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit, e cila, brenda 15 ditëve, fillon procedurën e dhënies me qira të objektit.

II. Përcaktimi i çmimit dysheme

Çmimi dysheme i qirasë mujore për fillimin e ankandit caktohet si shumë e çmimeve të ndërtesës, truallit të lirë funksional (jo nën ndërtesë), linjave teknologjike, makineri-pajisjeve, galerive etj., të përcaktuara si më poshtë:

II.1. Për sipërfaqen ndërtesë. Ndërtesat quhen të tilla sipas përcaktimeve të pikës 115, të Rregullores së Urbanistikës, miratuar me vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës".

a) Për ndërtesat:

- brenda unazës së vjetër të Bashkisë së Tiranës 300 lekë/m² në muaj dhe jashtë unazës, por brenda vijave kufizuese të Bashkisë së Tiranës, 200 lekë/m² në muaj;

- brenda vijave kufizuese të bashkive: Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë 150 lekë/m² në muaj;

- jashtë vijave kufizuese të bashkive të përmendura më lart 100 lekë/m² në muaj;

- brenda vijave kufizuese të bashkive: Bilisht, Ersekë, Ballsh, Peqin, Tepelenë, Dibër, Pukë, Kukës, Përmet, Delvinë, Bulqizë, Gramsh, Has, Kuçovë, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Rrëshen, Skrapar, Tropojë, Ura Vajgurore, Manëz, Sukth, Shijak, Fushë-Krujë, Cërrik, Patos, Roskovec, Divjakë, Libohovë, Maliq, Shëngjin, Vau i Dejës, Kamë, Vorë, Rrogozhinë, Himarë, Selenicë, Orikum, Konispol, si dhe të bashkive të tjera, që do të shpallen të tilla me akte ligjore, 80 lekë/m² në muaj;

- jashtë vijave kufizuese të bashkive të përmendura më lart 50 lekë/m² në muaj.

b) Për zyra, dyqane "Duty Free" dhe agjenci shërbimi në aeroporte, porte, dogana 2500 lekë/m² në muaj.

c) Për ndërtesat në institucionet me karakter kombëtar, sipas klasifikimit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, që janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve:

- në Bashkinë e Tiranës 600 lekë/m² në muaj;

- në bashkitë e tjera 300 lekë/m² në muaj.

II.2. Për makineritë, pajisjet, linjat teknologjike e galeritë minerare, qiraja vjetore llogaritet sipas VAM-it, të llogaritur në kapitullin e parë, pika 3 e vendimit nr.192, datë 20.3.1998 të Këshillit të Ministrave, pjesëtuar me vitet e mbetura deri në amortizimin e plotë të tyre. Llogaritja e amortizimit të bëhet në përputhje me kriteret e vendimit nr.401, datë 23.10.1989 të Këshillit të Ministrave. Në rastin kur makineritë, pajisjet, linjat teknologjike e galeritë minerare janë të amortizuara, llogaritja e qirasë vjetore të bëhet sipas VAM-it, të përcaktuar nga ekspertë dhe të miratuar nga komisioni vlerësues i ndërmarrjes, pjesëtuar me 10.

II.3. Për rezervuarët, depozitat e karburantit dhe silloset, që jepen me qira me qëllim tregtimi, brenda vijave kufizuese të qyteteve: Tiranë, Berat, Durrës, Fier, Korçë, Lushnjë, Pogradec, Sarandë, Shkodër, Elbasan, Vlorë, Gjirokastër, Kavajë, Krujë, Laç, Lezhë, çmimi dysheme i qirasë është 300 lekë/m³ në muaj, ndërsa jashtë vijave kufizuese të qyteteve të mësipërme, si dhe në të gjitha zonat e tjera çmimi i qirasë është 200 lekë/m³ në muaj.

II.4. Për truallin funksional (jo nën ndërtesë), çmimi dysheme i qirasë vjetore është 1/10 e çmimit të shitjes së truallit, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

II.5. Për terrenet sportive, çmimi dysheme i qirasë mujore është 30 lekë/m² në muaj.

III. Shpërndarja e të ardhurave

III.1. Të ardhurat nga dhëniet me qira të ndahen si më poshtë vijon:

- mbi 40 për qind Buxhetit të Shtetit;

-10 për qind Ministrisë së Ekonomisë;

-10 për qind organit të varësisë administrative të ndërmarrjes, shoqërisë a institucionit shtetëror;

- deri 40 për qind ndërmarrjes, shoqërisë a institucionit shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira, të cilat do të përdoren:

- për të mbuluar detyrimet e ndërmarrjes, të shoqërisë a institucionit shtetëror, të dhënë me qira;

- për shlyerjen e tatimeve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

- për shpenzime, për paga dhe shtesa mbi pagë të ndërmarrjes;

- për të mbuluar shpenzimet për riparime, përjashto punimet e përditshme për mirëmbajtje.

III.2. Agjencia Kombëtare e Privatizimit merr vlerën e qirasë së një muaji të objektit që jepet me qira.

IV. Procedurat e zhvillimit të ankandit

IV.1. Agjencia Kombëtare e Privatizimit merr dosjen për qiradhënie, fillon procedurat e publikimit, duke bërë njoftim në tri gazeta me qarkullim kombëtar, të paktën katër herë në dy javët e para.

IV.2. Njoftimi për publikim duhet të përmbajë të dhënat përkatëse për:

- emërtimin dhe vendndodhjen e objektit që jepet me qira;
- vlerën fillestare të ankandit;
- sipërfaqen e objektit (ndërtesë dhe truall);
- numrin e llogarisë së Agjencisë Kombëtare të Privatizimit, në të cilin do të bëhet pagesa në lekë e ofertës nga të gjithë pjesëmarrësit në ankand;
- vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;
- afatin e dhënies me qira të objektit.

IV.3. Ankandi zhvillohet jo më pak se 21 ditë pas publikimit të parë.

IV.4. Pjesëmarrësit në ankand në datën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit duhet të paraqesin në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit kërkesën për marrjen me qira të objektit, dokumentin që vërteton pagesën në lekë, të barazvlefshme për tre muaj të vlerës së ofertës së qirasë mujore, e cila, në çdo rast, nuk duhet të jetë më e ulët se vlera fillestare e ankandit, e publikuar nga Agjencia Kombëtare e Privatizimit. Kur dy ose më shumë oferta kanë të njëjtën vlerë, ankandi përsëritet.

IV.5. Ankandi zhvillohet në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit nga komisioni i ankandit, i cili ka në përbërje:

- | | |
|---|---------|
| - përfaqësuesin e AKP-së | kryetar |
| - përfaqësuesin e pronarit | anëtar |
| - përfaqësuesin e organit që ka objektin në administrim | anëtar |
| - përfaqësuesin e ndërmarrjes, shoqërisë a institucionit shtetëror, që ka objektin që jepet me qira | anëtar |

Pjesëmarrja e anëtarëve të komisionit të ankandit, në datën dhe orën e caktuar për ankand, është e detyrueshme.

IV.6. Ankandi zhvillohet në datën, vendin dhe orën e caktuar në publikim.

IV.7. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

- të regjistrojë dhe vërtetojë identitetin e subjekteve pjesëmarrës në ankand, sipas dokumenteve të tyre identifikuese;
- të paraqesë anëtarët e komisionit të ankandit;
- të deklarojë ofertën fituese të ankandit;
- pjesëmarrësit në ankand të deklarojnë me shkrim para komisionit të ankandit se janë në dijeni dhe pajtohen me gjendjen e objektit të publikuar.

Oferta fituese e ankandit shpallet menjëherë pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit dhe të vlerësimit të ofertave. Kur ka më shumë se një ofertë fituese me vlerë të barabartë, fituesi shpallet me short.

IV.8. Brenda 5 ditëve nga përfundimi i procedurave të ankandit, Agjencia Kombëtare e Privatizimit lidh kontratën me fituesin dhe e dërgon dokumentacionin e dhënies me qira dhe një kopje të kontratës me Ministrinë e Ekonomisë.

Organi që ka të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore, brenda 5 ditëve nga marrja e dokumentacionit, nxjerr udhëzimin për dorëzimin e objektit të marrë me qira nga ndërmarrja, shoqëria a institucioni shtetëror te fituesi i ankandit. Procesverbali i dorëzimit të jetë pjesë e kontratës.

IV.9. Pjesëmarrësve të tjerë (përveç fituesit) u kthehet vlera e parapagimit brenda 20 ditëve pas përfundimit të ankandit. Agjencia Kombëtare e Privatizimit derdh brenda 20 ditëve vlerën e dy muajve të qirasë së parapaguar nga fituesi i ankandit në llogarinë e përfaqësuesit të pronës shtetërore.

IV.10. Në rast se fituesi i ankandit nuk pranon ose tërhiqet nga lidhja e kontratës së qirasë, ai humbet vlerën e parapagimit të ankandit dhe procedura fillon nga e para, me publikimin në gazetë.

IV.11. Në rast se në ditën dhe orën e caktuar për zhvillimin e ankandit nuk paraqitet asnjë kërkesë, Agjencia Kombëtare e Privatizimit i kthen dokumentacionin organit që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronës shtetërore.

IV.12. Monitorimi i kontratave të qirasë bëhet nga Ministria e Ekonomisë.

V.Dispozita të fundit

V.1. Vendimi nr.430, datë 9.7.1998 i Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 343, datë 11.7.2002

**PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE JURIDIKË,
PUBLIKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të Kodit të Procedurave Administrative, të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtuesit e institucioneve shtetërore apo dhe të personave të tjerë juridikë, publikë, kanë të drejtë të urdhërojnë pajisjen me numër telefoni celular të personave zyrtarë, bazuar në detyrën që kryejnë dhe brenda fondeve të parashikuara në buxhetin vjetor.

2. Ky shërbim mund t'u ofrohet me dalje ndërkombëtare dhe pa kufizim në përballimin e shpenzimeve nga buxheti i institucionit funksionarëve, sipas shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Përfituesve të shtojcës nr.2 u përballohen shpenzimet në masën jo më shumë se 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa të tjerëve jo më shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

3. Këto institucione ose persona juridikë, publikë, janë të lira të lidhin kontratat, pa afat ose me afat (kartë telefonike) për këtë shërbim me cilindo prej operatorëve telefonikë, që veprojnë në vend, të cilët kanë epërsi në përmbushjen e këtyre kushteve:

- ofrojnë çmimin më të ulët;
- cilësinë më të mirë;
- shtrirjen më të gjerë të mbulimit me sinjal.

4. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë një udhëzim të posaçëm, për të përcaktuar raportin e shpenzimeve për këtë shërbim me ato operative, si dhe për të përcaktuar kufizime në parashikimin e shpenzimeve vjetore për këtë shërbim.

5. Vendimi nr.248, datë 25.3.1996 i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e numrit dhe kategorisë së telefonave celularë në përdorim të institucioneve buxhetore", me ndryshimet përkatëse, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

SHTOJCA NR.1

Presidenti i Republikës
Kryetari i Kuvendit
Kryeministri
Kryetari i Gjykatës së Kushtetuese
Kryetari i Gjykatës së Lartë
Prokurori i Përgjithshëm
Zëvendëskryetari i Kuvendit
Zëvendëskryeministri
Ministri
Sekretari i Përgjithshëm në Presidencë, Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave
Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, i Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit,
si dhe çdo funksionar i barazuar me ta në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe a të barabartë me atë që i përgjigjet funksionit të pikës 11.

SHTOJCA NR.2

Zëvendësministri
Sekretari i Përgjithshëm në ministri
Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme,
si dhe çdo funksionar i barazuar me ta në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe a të barabartë me atë që i përgjigjet funksionit të pikës 3.

VENDIM

Nr. 346, datë 13.6.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET PËRKATËSE DHE TË LIGJIT NR.7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË" , NDRYSHUAR ME LIGJET PËRKATËSE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet përkatëse, dhe të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Në kapitullin I "Sigurimi i detyrueshëm" bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - në pikën 3, fjala "muaj" zëvendësohet me "javë".
 - Pika 5 ndryshohet si më poshtë vijon:

"5. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën e caktuar, për femrat dhe meshkujt, në nenin 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të cilët nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, për barrë-lindjeje, për pensionet dhe sigurimin shëndetësor."

2. Në kapitullin II "Shuma bazë e përfitimeve" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Në mbështetje të neneve 2, 32, 36 dhe 48 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", shuma bazë e përfitimit, nga data 1.7.2002 e në vazhdim, të jetë 6 116 lekë në muaj."

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Në mbështetje të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, për personat që nuk plotësojnë kushtet për përfitim të masës së pensionit, të përcaktuar nga paragrafi i parë i këtij neni, shuma bazë e përfitimit, nga data 1.7.2002 e në vazhdim, të jetë 2 158 lekë në muaj."

3. Në kapitullin III "Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve" bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Shuma minimale mujore e kontributeve për të gjitha degët e sigurimit, për periudhën 1.7.2002 e në vazhdim, të jetë 3 940 lekë. Kontributi minimal mujor, sipas degëve të sigurimit, të jetë:

	<i>në lekë</i>
Dega e sigurimit të sëmundjeve	75
Dega e sigurimit të barrë-lindjeve	216
Dega e sigurimit të pensioneve	2812
Dega e sigurimit të aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale	47
Dega e sigurimit të papunësisë	470
Sigurimet shëndetësore	320

- Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Punëdhënësi të derdhë kontribute të detyrueshme në masën 41.9 për qind të pagës mujore, sipas listëpagesës. Nga data 1.7.2002 e në vazhdim, paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të jetë 9 403 lekë, ndërsa paga maksimale të jetë 47 015 lekë."

- Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

"3. Punëdhënësi privat, i vetëpunësuarit, të vetëpunësuarit në ortakëri, që ushtrojnë veprimtari ekonomike (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2002 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore, minimale, prej 9 403 lekësh."

- Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Pjesëtarët e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me punëdhënësin privat dhe të vetëpunësuarin (me përjashtim të të vetëpunësuarit në bujqësi), duke filluar nga data 1.7.2002 e në vazhdim, të derdhin kontribut të detyrueshëm për sigurimet, shoqërore dhe shëndetësore, në masën 39.2 për qind të pagës mujore minimale prej 9 403 lekësh."

- Në pikën 5 shifra "8 396" zëvendësohet me "9 403".

4. Në paragrafin e dytë të kapitullit V "Pagesa e kontributeve", shifra "11.7" zëvendësohet me "11.2" dhe shifra "34.2" zëvendësohet me "30.7".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2002.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

VENDIM
Nr. 39, datë 30.5.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	“
Nikoleta Kita	“
Valentina Kondili	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Irma Bala	“
Vladimir Bineri	“
Vladimir Metani	“
Metush Saraçi	“
Artan Hoxha	“
Natasha Sheshi	“
Spiro Spiro	“

në seancën gjyqësore të datës 30.5.2002, mori në shqyrtim çështjen civile nr.39, që i përket:

PADITËS: GJERGJI POJANI, i datëlindjes 1968, banues në Korçë.

I PADITUR: SHOQËRIA TREGTARE “BIRRA KORÇA” sh.p.k., me seli në Korçë

OBJEKTI: Konstatimi i pavlefshmërisë së vendimit nr.1, datë 3.11.1994 i mbledhjes së ortakëve të shoqërisë tregtare “Birra Korça” sh.p.k.

Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr. 3268, datë 26.12.1995, ka vendosur:

Rrëzimin e padisë së paditësit Gjergji Pojani si të pabazuar në ligj e në prova.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.2912, datë 15.5.1996, vendosi:

Prishjen e vendimit të mësipërm dhe kthimin e çështjes për rigjykim, po asaj gjykate, me trup gjykues tjetër.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ka paraqitur ankim në Gjykatën e Kasacionit i padituri.

- Gjykata e Kasacionit, me vendimin nr.86, datë 14.1.1997, vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes, për rigjykim, në po atë gjykatë, me trup gjykues tjetër.

- Mbas rigjykimit, me vendimin nr.1637, datë 18. 6.1997, Gjykata e Apelit Tiranë vendosi lënien në fuqi të vendimit nr.3268, datë 26.12.1995 të Gjykatës së Rrethit Korçë.

Kundër këtij vendimi, paditësi ka paraqitur rekurs në interes të ligjit, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin kërkon prishjen e tij, duke parashtruar shkaqet e mëposhtme:

- Nenet 46 dhe 47 të ligjit “Për shoqëritë tregtare” nuk kanë asnjë lidhje me vendimin nr.1, të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë “Birra Korça” që është objekt i gjykimit të çështjes, pasi ato bëjnë fjalë për transferimin e pjesëve të kapitalit, kurse nga përmbajtja e vendimit të mësipërm del se ortaku Gjergji Pojani përjashtohet nga shoqëria, për shkak se, si administratori i saj, konsiderohet fajtor për prodhimin e birrës jashtë standardit. Ndryshe nga sa pranon gjykata, në këtë vendim të Asamblesë së Ortakëve nuk bëhet fjalë për transferimin e pjesëve të kapitalit ose për heqje dorë nga ortakëria.

- Asambleja e Ortakëve vendimin e saj e bazon në nenet 53, 55 dhe 59 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, të cilat bëjnë fjalë për përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e administratorëve, në një kohë kur unë nuk kam qenë i zgjedhur asnjëherë administrator i shoqërisë.

- Duke më përjashtuar mua nga shoqëria, Asambleja e Ortakëve ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, sipas të cilit shoqëria themelohet nga dy ose më shumë persona, nëpërmjet një kontrate. Sipas nenit 690 të Kodit Civil, kontrata e themelimit të shoqërisë ka forcën e ligjit dhe mund të prishet ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve për shkaqe të parashikuara në ligj, gjë që do të thotë se nuk mund të përjashtohet nga shoqëria një ortak në mënyrë të njëanshme, siç është vepruar në rastin tim.

- Vendimi nr.1, datë 3.11.1994 i Asamblesë së Ortakëve është i kundërligjshëm dhe, si i tillë, në bazë të nenit 213/3 të ligjit “Për shoqëritë tregtare”, është i pavlefshëm.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionet e anëtarëve të Gjykatës së Lartë, Spiro Spiro e Natasha Sheshi; përfaqësuesin e paditësit, avokat Përparim Sanxhaku, i cili kërkoi të prishë të dy vendimet dhe pranimin e padisë; përfaqësuesin e të paditurit, avokat Vasil Plaku, i cili kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Nga shqyrtimi i akteve që ndodhen në dosjen civile nr.3643, me paditës Gjergji Pojani dhe të paditur, shoqëria tregtare “Birra Korça” sh.p.k., si dhe gjatë gjykimit të çështjes në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, rezultoi se, në bazë të akteve të themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin “Birra Korça” sh.p.k., me seli në qytetin e Korçës, paditësi është një nga të njëmbëdhjetë ortakët themelues të kësaj shoqërie, me kontribut në kapitalin e saj një të njëmbëdhjetën pjesë të tij, aq sa është edhe kontributi i dhjetë ortakëve të tjerë të saj.

Sipas vendimit nr.1, datë 3.11.1994, mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie, duke e konsideruar fajtor paditësin për shkelje të rënda dhe të përsëritura të procesit teknologjik për prodhimin e birrës, gjatë administrimit si administrator, me detyrën e kimistit teknolog, mori vendim që ai të zhëmtonte dëmin e shkaktuar nga prodhimi i birrës jashtë standardit, duke e shlyer atë nëpërmjet mbajtjes së një milion lekëve, që ishte masa e kontributit fillestar të tij në krijimin e kapitalit themeltar të shoqërisë.

Vendimi i përmendur më lart shprehet dhe se, duke mbetur pa kontribut, paditësi përjashtohet nga shoqëria.

Këtë vendim të saj mbledhja e Asamblesë së Ortakëve e ka bazuar në nenet 14, 17, dhe 22 të Statutit të shoqërisë dhe nenet 53, 55 e 59 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Vendimin e mësipërm të Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve, paditësi e kundërshtoi, duke kërkuar, gjyqësisht, konstatimin e pavlefshmërisë së tij, me pretendimin se, jo vetëm që ai nuk ishte emëruar administrator i shoqërisë tregtare “Birra Korça” sh.p.k., por edhe se shuma prej 1 milion lekë, që ishte kontribut i tij në kapitalin që mbajtur në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për shoqëritë tregtare”, si dhe nuk mund të përjashtohet si ortak i kësaj shoqërie pa dhënë pëlqimin e tij.

Gjykata e Rrethit Korçë, me vendimin nr.3268, datë 26.12.1995, vendosi rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj e në prova, vendim i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e saj nr.1637, datë 18.6.1997.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arritën në përfundimin se të dy këto vendime janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe provat e administruara gjatë gjykimit të çështjes dhe, për rrjedhojë, duhet të ndryshohen.

Në këtë përfundim u arrit pasi, nga përmbajtja e dispozitave të kreut të IV të ligjit nr.7698, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të cilat rregullojnë mënyrën e krijimit, formimit e kapitalit themeltar, pozicionin e ortakëve, marrëdhëniet midis tyre, organet drejtuese dhe modalitetet e tjera të funksionimit të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, rezulton që ortaku (kur janë më shumë se një) i një shoqërie të kësaj forme (sh.p.k.) nuk mund të përjashtohet nga të qenit ortak, pra nga ortakëria, për asnjë veprimtari të ushtruar prej tij në këtë shoqëri, pavarësisht nga natyra dhe pasojat që mund t'i vijnë shoqërisë nga kjo veprimtari.

Pas plotësimit me korrektësi të detyrimeve që rrjedhin nga Akti i Themelimit (kontrata) dhe statuti i shoqërisë, që është pjesë e pandarë përbërëse e tij, sikurse janë nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar (neni 40 i ligjit nr.7638, datë 19.1.1992), ofrimi efektiv i kontributeve (kur ndodhemi para rastit të krijimit të kapitalit themeltar me kontribute në natyrë, neni 42 i ligjit të përmendur) dhe respektimi i formaliteteve të regjistrimit që kërkohen nga ligji 7667, datë 28.1.1993 “Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare”, secili prej ortakëve të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, gëzon të gjitha të drejtat që burojnë nga fakti i të qenit ortak i saj, natyrisht në masën e përcaktuar nga ligji, masë e cila kushtëzohet nga vlera konkrete e pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë, e cila, aritmetikisht, llogaritet në përqindje.

Të vetmet detyrime ligjore të ortakut të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar janë së pari, ato që rrjedhin në rast se, në fund të vitit ekonomiko-financiar, shoqëria rezulton me humbje, humbje, që edhe këto sipas përmbajtjes së paragrafit të parë të nenit 37 të ligjit 7638, datë 19.11.1992 përballohen vetëm në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar dhe së dyti, detyrimi për të pranuar çdo vendim të Asamblesë së ortakëve me rastin e zëvendësimit të kapitalit, me kusht që, ashtu sikurse përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 64 të ligjit të përmendur, zvogëlimi i kapitalit t'i prekë të gjithë ortakët e një shoqërie në të njëjtën masë që ata përfaqësojnë në pjesët (kuotat) takuese të kapitalit të kësaj shoqërie.

Mbarimi i mandatit nominal i një ortaku të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, përveç vdekjes së tij, vërtetohet në praktikë në njërin prej rasteve që parashikohen në dispozitat e neneve 46 (transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar me trashëgim ose brenda familjes), 47 (transferimi të të tretët) dhe 49 (Transferimi ndërmjet ortakëve) të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare, rrethana këto që, sikurse rezulton nga aktet që janë administruar gjatë gjykimit të çështjes, nuk kanë ekzistuar në rastin e marrjes së vendimit nr.1, datë 3.11.1994 të mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë tregtare “Birra Korça” sh.p.k.

Përveç kësaj, gjatë shqyrtimit të akteve që ndodhen në dosje, ndryshe nga ç'thuhet në vendimin e përmendur të Asamblesë së Ortakëve, paditësi nuk figuron të ketë qenë emëruar as administrator i saj, as i punësuar si teknolog në këtë shoqëri. Përkundrazi, sipas nenit 22 të Statusit të Shoqërisë Tregtare “Birra Korça” sh.p.k., i punësuar si teknolog ishte caktuar i ati i paditësit, i quajtur Koço Pojani, veprimet e të cilit mund të kenë qenë shkak i prodhimit të birrës jashtë standardit që mund të ketë sjellë dëmin ekonomik të pretenduar nga ortakët pjesëmarrës në mbledhjen e datës 3.11.1994.

Por, edhe sikur të qëndronte pretendimi i ortakëve pjesëmarrës në këtë mbledhje, sipas përmbajtjes së dispozitës së nenit 53 të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, ata legjitimoheshin të kërkonin zhdëmtim për dëmin e shkaktuar me padi për shlyerjen e dëmit.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, bazuar në shkronjën “d” të nenit 485 të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Ndryshimin e vendimeve, nr.3262, datë 26.12.1995 të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe nr.1637, datë 18.6.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësit Gjergji Pojani.

Ky vendim është unifikues. Një kopje e tij të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr. 46, datë 6.6.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË”

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga :

Thimjo Kondi	Kryesues
Perikli Zaharia	Anëtar
Kristaq Ngjela	“
Nikoleta Kita	“
Vladimir Bineri	“
Metush Saraçi	“
Evgjeni Sinoimeri	“
Irma Bala	“
Bashkim Caka	“
Natasha Sheshi	“
Ylvi Myrtja	“
Agron Lamaj	“
Vladimir Metani	“

në datat 31.5.2002 dhe 6.6.2002 morën në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me nr.47 akti, që u përket palëve :

PADITËS: DHIMITRAQ SHOMO, në mungesë.

TË PADITUR:

1. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE pranë BASHKISË KORÇË, në mungesë.

2. MARIKA CALE; EMILI QANO; LILJANA KATUNDI, të përfaqësuar me prokurë nga avokat Kujtim Capo.

3. HARIKLI MUSHI, në mungesë.

4. IRENA PRIFTI, në mungesë.

5. ALBERT PLUMBI, në mungesë.

6. GJERGJI MIKEREZI, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: - Anulim i vendimit nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë.

- Detyrim njohje pronare.

Baza ligjore e padisë: Ligji nr.7698, datë 15.4.1993.

- Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 2095, datë 10.8.1995, ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë.

- Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e paditësit, me vendimin nr.1956 datë 29.3.1996, ka vendosur :

- Prishjen e vendimit nr.2095, datë 10.8.1995 të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, në rigjykim, me vendimin nr. 2843, datë 20.8.1996, ka vendosur:

- Rrëzimin e padisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e paditësit, me vendimin nr.6803, datë 29.11.1996, ka vendosur:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.2843, datë 20.8.1996 të Gjykatës së Rrethit Korçë.

Gjykata e Lartë, me vendimin nr.311, datë 20.2.1997, ka vendosur:
- Prishjen e vendimit nr.6803, datë 29.11.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
Gjykata e Apelit Tiranë, në rigjykim, me vendimin nr.1195, datë 25.4.1997, ka vendosur :
- Prishjen e vendimit nr.2843, datë 20.8.1996 të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.
Gjykata e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin nr. 358, datë 9.3.1998, ka vendosur:
- Rrëzimin e padisë.
Gjykata e Apelit Korçë, mbi ankimin e paditësit, me vendimin nr.242, datë 17.11.1998, ka vendosur :
- Ndryshimin e vendimit nr.358, datë 9.3.1998 të Gjykatës së Rrethit Korçë, si më poshtë:
Pranimin e kërkesë-padisë së paditësit Dhimitraq Shomo, duke anuluar vendimin nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë dhe njohjen pronar të paditësit Dhimitraq Shomo mbi një dyqan me kufizimet : V-Petraq Shomo, L-Bulevardi “Republika”, J-Petraq Shomo, P-Petraq G. Shomo me sipërfaqe 55m2.
Gjykata e Lartë, mbi ankimin e të paditurve, me vendimin nr.1152, datë 21.12.1999, ka vendosur:
- Mospranimin e rekursit të paraqitur nga e paditura Marika Çale si të pabazuar në ligj.
Kundër vendimit të formës së prerë, në bazë të nenit 473 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me nenin 5 të ligjit nr.8431, datë 14.12.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, kanë ushtruar rekurs të paditurit, të cilët kërkojnë prishjen e vendimit, duke parashtruar këto shkaqe :
- Prona është shitur nga trashëgimlënësi në vitin 1934, por kjo shitje është anuluar në bazë të dekret-ligjit nr.355, datë 21.11.1946, duke iu marrë trashëgimlënësit të paditësit.
- Prona nuk i është marrë ish-pronarit në mënyrë të padrejtë. Dekret ligji i vitit 1946 ka karakter thjesht juridiko-civil.
- Gjykata ka interpretuar gabim nenin 1 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 duke ia kthyer pronën paditësit.
- Padia e paditësit, për deklarimin e pavlefshëm të vendimit të Zyrës së Përmbarrimit nr. 137, datë 18.2.1948, është rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin përkatës të anëtarëve Vladimir Metani dhe Kristaq Ngjela,
pasi dëgjuan përfaqësuesin e të paditurave Marika Cale, Emili Qano dhe Liljana Katundi,
avokat Kujtim Capo, i cili kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe pasi diskutuan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë nr.242, datë 17.11.1998, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr.358, datë 9.3.1998 të Gjykatës së Rrethit Korçë, duke pranuar padinë se paditësit Dhimitraq Shomo dhe anuluar vendimin nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë dhe njohjen pronar të paditësit Dhimitraq Shomo mbi një dyqan me kufizimet : V- Petraq Shomo, L-Bulevardi “Republika”, J- Petraq Shomo, P- Petraq G. Shomo me sipërfaqe 55 m2, është i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të priset, ndërsa vendimi nr. 358, datë 9.3.1998 i Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, me të cilin është vendosur rrëzimi i padisë, është i drejtë, i bazuar në ligj dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezultojnë e provuar si më poshtë :

Paditësi Dhimitraq Shomo është trashëgimtar ligjor i të ndjerit Petraq Shomo, ndërsa të paditurit Marika Cale etj., janë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit Thimaq Cale.

Trashëgimlënësit e palëve në gjykim, në vitet '30 kanë pasë hyrë në disa marrëdhënie huaje me njëri-tjetrin, ku i ndjeri Thimaq Cale (trashëgimlënësi i të paditurve) ka qenë në pozitën e huamarrësit, ndërsa i ndjeri Petraq Shomo (trashëgimlënësi i paditësit) ka qenë në pozitën e huadhënësit. Konkretisht, sipas vërtetimit të datës 3.10.1994, të lëshuar nga Hipoteka Korçë, me aktet publike datë 24.6.1932, datë 16.9.1932 dhe datë 24.6.1932 është marrë hua shuma prej rreth 950 napolona ari metal. Detyrimet e mësipërme janë siguruar me lënien në hipotekë të pjesës së zotëruar nga huamarrësi mbi një banesë me apartamente sipër dhe dyqane poshtë, duke u inskriptuar kjo pasuri në favor të kreditorit. Nga përmbajtja e regjistrave të hipotekës rezulton që të tri hipotekat janë fshirë me akt publik me nr.9560/6425, datë 20 tetor 1934 dhe të noteruar (regjistruar) me nr.32/9, datë 23 tetor 1934, mbasi të hollat u paguan plotësisht.

Një vit më vonë, me kontratën e shitjes të datës 26 tetor 1935, i ndjeri Thimaq Cale i ka shitur të ndjerit Petraq Shomo një shtëpi të ndarë, të përbërë prej dy apartamentesh për banim, së bashku me 6 dyqane përposh, me gjithë vendin që okupon kjo pronë, kundrejt shumës 2500 napolona ari metal.

Me daljen e ligjit nr. 355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave të lindura para datës 29.11.1944”, Kryesia e përbarimit, në zbatim të nenit 9 të këtij ligji, me vendimin nr. 137 datë 18.2.1948 ka vendosur: “... kthimin dhe dorëzimin tek Thimaq Cale, banues në Korçë, vetëm të një dyqani, ndodhur në lagjen nr.4 të Korçës, në rrugën “Bulevardi Republika”, nr.1/2 me kufij të tashëm... dyqan i cili bën pjesë në godinën e madhe dhe që sot mbahet me qira prej vëllazërisë Cici dhe përdoret për ëmbëltoje dhe së bashku me shtëpinë dhe dyqanet e tjera është transkriptuar me nr.369/9, datë 28 tetor 1935 mbi emrin e Petraq Gaqi Shomo. Prandaj, lutemi të bëhen veprimet e duhura në radhoret e asaj zyre dhe të fshihet transkriptimi me nr. 369/9, datë 28 tetor 1935 vetëm përsa i përket dyqanit të mësipërm.”. Vendimi i mësipërm i Zyrës së Përbarimit është regjistruar me nr. 491/12, datë 27.2.1948 dhe më vonë, në bazë të dekret-ligjit nr.801, datë 22.3.1950 të Presidiumit të Kuvendit Popullor “Mbi shtetëzimin e disa ndërtesave”, prona e mësipërme, kthyer Thimaq Cales, është transkriptuar në favor të Shtetit Shqiptar.

Paditësi Dhimitraq Shomo, këtë vendim të Kryesisë së Përbarimit, e ka kundërshtuar me padi në gjykatë. Me vendimin gjyqësor nr.2023, datë 23.10.1994, Gjykata e Rrethit Korçë ka rrëzuar padinë. Ky vendim ka marrë formë të prerë pasi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, ndërsa Gjykata e Kasacionit ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

Me daljen e ligjit nr.7698, datë 15.2.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, trashëgimtarët e të ndjerëve Petraq Shomo dhe Thimaq Cale, i janë drejtuar Komisionit Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë për njohjen, identifikimin dhe kthimin e ish-pronave të trashëgimlënësve të tyre. Ky komision, me vendimin nr.78, datë 1.10.1993, dhënë në favor të paditësit, ka vendosur : “Të miratojë të drejtën e pronësisë së trashëgimtarëve të Petraq Shomos... për kthimin e pronës një shtëpi me 5 dyqane poshtë, e ndodhur në lagjen nr.12 ... e cila pronë me gjithë oborrin ka sipërfaqe 405m2. Nga sipërfaqe e dyqaneve prej 297m2 të zbritet një sipërfaqe prej 54,6m2 (4,2x13) që është me pronësi tjetër...”. Ndërsa me vendimin nr.229, datë 8.4.1994 dhënë në favor të të paditurve ka vendosur : “Të miratojë të drejtën e pronësisë së ish-pronarit Thimaq Llambro Cale... për kthimin e pronës së ndodhur në Bulevardin Republika, e përbërë nga një dyqan me kufizimet ... me sipërfaqe 55m2”.

Duke pretenduar se vendimi nr. 229, datë 8.4.1994 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, dhënë në favor të të paditurve është i padrejtë, pasi objekti në fjalë, dyqan me sipërfaqe 55 m2 është pronë e trashëgimlënësit të paditësit, prej këtij të fundit me padinë në gjykim është kërkuar anulimi i vendimit nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, pranë Bashkisë Korçë dhe detyrimi i të paditurve ta njohin paditësin pronar mbi këtë dyqan. Në padi pretendohet gjithashtu se dyqani, së bashku me gjithë ambientet e tjera të godinës, ka qenë në pronësi të trashëgimlënësit të tij, qysh në vitin 1935, pronësi kjo e fituar me kontratën e shitjes së lidhur mes Petraq Shomos si blerës dhe Thimaq Cales si shitës dhe kjo shitje nuk ka qenë e lidhur me ndonjë hua, pra nuk mund të jetë objekt i ligjit nr.355, datë 21.11.1946.

Më tej, pretendohet se huatë e marra janë likujduar prej huamarrësit qysh në vitin 1934, ndaj veprimet përbarimore, që kanë urdhëruar hipotekën të bëjë kalimin e këtij dyqani në pronësi të Thimaq Calës, janë fiktive.

Pas disa gjykimeve, Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë me arsyetimin se pretendimet e paditësit mbi pavlefshmërinë e veprimeve të Zyrës së Përbarimit për kalimin e dyqanit nga Petraq Shomo tek Thimaq Çale janë rrëzuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Korçë dhe ka pranuar padinë, duke anuluar vendimin nr.229, datë 8.4.1994 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë Korçë dhe njohten pronar të paditësit Dhimitraq Shomo mbi këtë dyqan me arsyetimin se ky objekt që, në bazë të kontratës së shitjes të vitit 1935, ka kaluar në pronësi të Petraq Shomos, provohet që është marrë kundër dëshirës së ish-pronarit Petraq Shomo dhe në bazë të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, neni 1, i cili ka shfuqizuar ligjin nr.355, datë 21.11.1946, çdo akt administrativ i kryer në bazë të atij ligji, është i pavlefshëm.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se vendimi i mësipërm i Gjykatës së Apelit Korçë, është i pabazuar në ligj.

Kështu, ligji nr.7698, datë 15.2.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” në tërësinë e tij rregullon marrëdhëniet juridike midis shtetit dhe ish-pronarëve, duke marrë përsipër t’u kthejë këtyre të fundit pronat e marra në një nga format e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji, siç mund të jenë shtetëzimi, konfiskimi, sekuestrimi etj., ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër.

Ndërsa ligji nr.355, datë 21.11.1946 “Mbi shlyerjen e huave të lindura para datës 29.11.1944” rregullon marrëdhëniet juridike midis individëve dhe kryesisht midis huadhënësit dhe huamarrësit. Sipas nenit 9 të këtij ligji: “Kur një pronë është vënë në hipotekë për hua pas datës 1.4.1929 dhe kjo pronë ndodhet sot me titull zotërimi në duart e huadhënësit, atëherë prona e hipotekuar i kthehet huamarrësit”.

Gjithashtu, sipas nenit 7 të këtij ligji: “Kur pronën e shitur me pakt riblemje e ka huadhënësi në zotërimin e tij, atëherë kjo i kthehet menjëherë huamarrësit”.

Duke analizuar përmbajtjen e këtyre dy ligjeve, nga pikëpamja e marrëdhënieve juridike që rregullojnë vërehet qartë dallimi se zbatimi i ligjit nr. 7698, datë 15.2.1993 dhe pasojat që vijnë prej tij, nuk kanë të bëjnë aspak me pasojat e rrjedhura nga zbatimi i ligjit nr.355, datë 21.11.1946.

Me hyrjen në fuqi, ligji nr.7698, datë 15.4.1993 nuk i shfuqizon efektet që kanë ardhur nga zbatimi i ligjit nr.355, datë 21.11.1946.

Ligji nr.7698, datë 15.4.1993, kur parashikon në nenin 1 të tij se “Ky ligj u njeh ish-pronarëve apo trashëgimtarëve të tyre të drejtën e pronësisë për pronat e shtetëzuara, të shpronësuara apo të konfiskuara sipas akteve ligjore, nënligjore e vendimeve të gjykatës të dala pas datës 29 nëntor 1944, ose të marra pa të drejtë nga shteti me çdo mënyrë tjetër ...” nuk përfshin në këtë përcaktim edhe efektet që kanë rrjedhur prej ligjit nr.355, datë 21.11.1946, nëpërmjet akteve e procedurave administrative apo gjyqësore të kryera në zbatim të këtij ligji.

Dy ligjet e lartpërmendura kanë rregulluar në kohë të ndryshme problematika të ndryshme, që s'kanë lidhje me njëra-tjetrën. Me ligjin për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve, shteti merr përsipër t'u kthejë ish-pronarëve, (trashëgimtarëve të tyre), në një masë të pranueshme, të arsyeshme e objektivist të mundshme, pronat e marra në mënyrë të paligjshme apo të padrejtë. Pra, rregullohen marrëdhënie midis subjektit shtet, nga njëra anë, dhe subjektit ish-pronar nga ana tjetër.

Ndërsa ligji nr.355, datë 21.11.1946 ka rregulluar në një mënyrë të ndryshme nga regjimi juridik i kohës (Kodi Civil i vitit 1929) marrëdhëniet midis subjekteve private, të krijuara nga huatë me kamatë të lartë, të mbuluara me hipoteka ose shitje me pakt riblerjeje. Në këto marrëdhënie juridiko-civile shteti nuk ka qenë palë, prandaj nuk ka marrë përsipër as në atë kohë, as më vonë, ndonjë detyrim të vetin ndaj subjekteve private.

Gjithashtu, parashikimi në nenin 29 të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993, sipas të cilit “Të gjitha dispozitat ligjore që vijnë në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen”, nuk mund të interpretohet në një mënyrë aq të zgjeruar sa të çojë në përfundimin se me të është shfuqizuar në mënyrë të heshtur e të nënkuptuar edhe ligji nr.355, datë 21.11.1946 me gjithë pasojat e zbatimit të tij. Ky ligj ka rregulluar marrëdhënie juridike të caktuara të imponuara nga rrethana dhe kërkesa të kohës kur ka dalë, sipas botëkuptimit të asaj kohe dhe qëllimeve të ligjvënësit. Koha kur ka dalë ky ligj është e kapërcyer dhe pasojat që kanë ardhur prej tij për çdo rast konkret përbëjnë të drejta të fituara nga persona të caktuara shumë kohë më parë.

Për sa më lart, konkludohet se Gjykata e Apelit në zgjidhjen e çështjes ka tejkaluar kufinj të zbatimit të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485 germa “ b ” të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 14 germa “c” të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.242, datë 17.11.1998 të Gjykatës së Apelit Korçë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 358, datë 9.3.1998 të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë.

2. Ky vendim është unifikues për praktikën gjyqësore dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Industrisë dhe Energjetikës pas lidhjes së akt-marrëveshjes me subjektin kërkues sh.a. “Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare” Tiranë, shpall kërkesën për shpronësim me interes publik, “Për zgjerimin e nënstacioneve Elbasan 400 kV, Elbasan 220 kV, si dhe linjën 220 kV ndërmjet tyre” në komunën Bradashesh dhe lagjen Skënderbej në rrethin e Elbasanit.

Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që kanë pasuri pronë private si: kantier prodhim material ndërtimi, tokë bujqësore, arë dhe ndërtesa të tjera të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që do të shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme:

1. Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësohet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 400 kV.

Kantier prodhim material ndërtimi dhe tokë arë

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip.m2	Vlera totale e pasurisë	Adresa
1.	Ilir Terziu	a) truall b) ndërtesë	2900 232	6.016.398 lekë	lagja: Fushë-Mbret Elbasan
2.	Bexhet Limani (përdorues)	Tokë are	2653	nuk kompensohet pronë shtetërore	lagja: Fushë-Mbret Elbasan

2. Lloji i pasurisë së paluajtshme që preket dhe shpronësohet nga zgjerimi i nënstacionit Elbasan 220 kV, si dhe nga ndërtimi i linjës 220 kV ndërmjet dy nënstacioneve:

Tokë bujqësore arë dhe shtëpi banimi

Nr.	Emër Mbiemër i pronarit	Nr. kadastral	Lloji i pasurisë	Sip në m2	Çmimi lekë/m2	Vlera e pasurisë që kompensohet shprehur në lekë	Adresa
1.	Veli Leshanaku	72	tokë arë	1400	1200	1 680 000	komuna Bradashesh
2.	Arben Leshanaku	72	“	697	“	836 400	komuna Bradashesh
3.	Jakup Leshanaku	72	“	42	“	50 400	komuna Bradashesh
4.	Nuredin Leshanaku	69	“	42	“	50 400	komuna Bradashesh
5.	Selman Leshanaku	140	“	30	“	36 000	komuna Bradashesh
6.	Banush Salla	141	“	43	“	51 600	komuna Bradashesh
7.	Sabri Mullohu	141	“	43	“	51 600	komuna Bradashesh
8.	Agim Hidri	189	“	25,5	“	30 600	komuna Bradashesh
9.	Bajram Hidri	189	“	25,5	“	30 600	komuna Bradashesh
10.	Faik Ramazani	198	“	17	“	20 400	komuna Bradashesh
11.	Zyber Kroba	198	“	17	“	20 400	komuna Bradashesh
12.	Jakov Berduti	37	“	52	“	62 400	komuna Bradashesh
13.	Ruzhdi Ago	41	“	56	“	67 200	komuna Bradashesh
14.	Qamil Korça		shtëpi banimi	100	-----	1 450 000	komuna Bradashesh
15.	Xhaferr Paenga	331,1	tokë are	43	1200	51 600	lagja: Skënderbej
16.	Shpëtim Kadri Gjeli	332,1	“	21,5	“	25 800	lagja: Skënderbej
17.	Lefter Ziu	382,1/2	“	21.5	“	25 800	lagja: Skënderbej
18.	Xhevit Hani	339_0,1	“	36	“	43 200	lagja: Skënderbej
19.	Shpresa Ruci	338_4	“	30	“	36 000	lagja: Skënderbej
20.	Bexhet Limani (përdorues)	428	“	42	“	nuk kompensohet pronë shtetërore	lagja: Skënderbej

3. Lloji i pasurisë që dëmtohet nga shpronësimi: kulturë bujqësore misër dhe jonxhë

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë e dëmtuar	Sip.m2	Vlera totale e pasurisë që zhdëmtohet	Adresa
1.	Veli Leshanaku	parcelë me misër	1400 m2	23 300 lekë	Bradashesh
2.	Arben Leshanaku	parcel me jonxhë	697 m2	13 400 lekë	“

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1 (një) javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim personat që kanë emrin në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës.

SHPALLJE KËRKESË PËR SHPRONËSIM

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurisë së paluajtshme të tokës arë me sipërfaqe 6000 m2, në fshatin Rrilë të Komunës Shënkoll, Lezhë, me pronar z. Lekë Gjon Bushi.

Subjekti kërkues është komuna Shënkoll, Lezhë. Me anë të këtij publikimi kërkohet të vëmë në dijeni, personin që preket nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni, ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të sipërfaqes sipas cenimit të ofruar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1 javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personi që ka emrin, ka të drejtë të paraqesë pretendimet të tij të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit).

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 26.7.2002
Doli nga shtypi më 27.7.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë